

## 100 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PËRPUNIMIN

Fusha përmban të dhënat e koduara që kanë të bëjnë me të gjitha llojet e regjistrimeve në bazën e njësuar të të dhënave. Fusha është e detyrueshme.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
100	Të dhënat e përgjithshme për përpunimin	nr
<b>b</b>	<i>Kodi për statusin e pikëqasjes së njësuar</i>	nr
<b>c</b>	<i>Gjuha e katalogimit</i>	nr
<b>d</b>	<i>Kodi për transliterimin</i>	nr
<b>g</b>	<i>Shkrimi i katalogimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 100b Kodi për statusin e pikëqasjes së njësuar

Kodi tregon statusin e pikëqasjes në regjistrimin e njësuar. Kjo nënfushë nuk duhet të ngatërrohet me nënfushën 001g – *Kodi i plotësisë së regjistrimit*, e cila ka të bëjë me regjistrimin në tërësi.

<b>a</b>	<i>e pranuar</i> Pikëqasja është e verifikuar dhe e pranuar (shih shembujt 1, 2, 3, 4).
<b>c</b>	<i>e përkohshme</i> Pikëqasja nuk është përfunduar për shkak të informacioneve të mangëta dhe të papërshtatshme. Kur të përdorni atë sërish duhet ta analizoni për informacionet e mundshme shtesë.
<b>x</b>	<i>pikëqasja e njësuar nuk ekziston</i> Regjistrimi është referues ose i përgjithshëm shpjegues, dhe për këtë arsye fusha 2XX përmban variantin e pikëqasjes ose pikëqasjen shpjeguese (shih shembullin 5).

### 100c Gjuha e katalogimit

Kodi ndahet në mënyrë automatike dhe tregon gjuhën që përdor biblioteka gjatë katalogimit (shih shembujt 3, 4).

Pikëqasja në fushën 2XX është krijuar sipas rregullave të katalogut, gjuha e të cilit është vendosur në këtë fushë. Të gjitha shtesat në fushën 2XX, shënimet dhe udhëzimet janë në gjuhën e katalogimit.

Pjesa kryesore e pikëqasjes mund të jetë edhe në një gjuhë tjetër nga ajo e katalogimit. P.sh. sipas disa rregullave të katalogimit titulli uniform i një vepre anonime franceze do të formohet në gjuhën franceze, pavarësisht gjuhës së katalogimit.

## 100d Kodi për transliterimin

Kodi tregon llojin e sistemit për transliterimin që përdoret për pjesën kryesore të pikëqasjes së parë në fushën 2XX.

<b>a</b>	<i>tabelë transliterimi ISO</i>
<b>b</b>	<i>tjetër</i>
<b>c</b>	<i>disa transliterime</i> Kodi përdoret kur në nënfushat 7 të fushave për pikëqasjet janë të vendosura disa shkrime (shih kap. Nënfisha 7).
<b>d</b>	<i>tabelë transliterimi e institucionit kombëtar bibliografik</i>
<b>e</b>	<i>transliterim pa tabela transliterimi të identifikuar</i>
<b>f</b>	<i>tabela të tjera transliterimi të identifikuar</i>
<b>y</b>	<i>transliterimi nuk ekziston</i>

## 100g Shkrimi i katalogimit

Kodi ndahet në mënyrë automatike dhe tregon shkrimin që është përdorur gjatë katalogimit. Në këtë lloj shkrimi janë shtesat në fushën 2XX, shënimet dhe udhëzimet e tjera.

<b>ba</b>	<i>latin</i> Shih shembullin 3.
<b>ca</b>	<i>cirilik - i papërcaktuar</i> Shih shembullin 4.
<b>cb</b>	<i>cirilik – serb*</i>
<b>cc</b>	<i>cirilik – maqedon*</i>

## SHEMBUJ

1.

100	uu	<b>ba cfre gba</b> <i>(Gjuha e katalogimit është gjuha franceze, ndërsa shkrimi latin.)</i>
-----	----	--

2.

100	uu	<b>ba cper gfa</b> <i>(Katalogimi është bërë në gjuhën persiane dhe në shkrim arab.)</i>
-----	----	---

3. \* COBISS.net

100	uu	<b>ba calb gba</b> <i>(Pikëqasja është e pranuar, gjuha e katalogimit është gjuha shqipe, shkrimi latin.)</i>
-----	----	--

## 4. \* COBISS.net

100	□□	<b>ba cbul gca</b> <i>(Pikëqasja është e pranuar, gjuha e katalogimit është gjuha bullgare, shkrimi cirilik.)</i>
-----	----	--

## 5. \* COBISS.net

100	□□	<b>bx csly gba</b> <i>(Pikëqasja në fushën 2XX është variant i pikëqasjes ose pikëqasje shpjeguese në regjistrimin referues ose në regjistrimin e përgjithshëm shpjegues, gjuha e katalogimit është gjuha sllovene, ndërsa shkrimi latin.)</i>
-----	----	---